



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:253091

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05709228

KPPP.nr. 1922/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ambiene Sh.P.K., me numër unik identifikues 811996886 dhe me seli në Podujevë, rr. "Hasan Ramadani", kundër debitorit "Trepça" Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, p.nr., duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 271/23, i lejuar me datë 06.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit "Trepça" Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 271/23, i lejuar me datë 06.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Isa Shala.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 271/23, i lejuar me datë 06.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Isa Shala, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. 05/2023, e datës 03.10.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 271/23, të datës 06.11.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 4,000.20, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se dokumentet në bazë të së cilave është marr urdhri përmbartues nuk janë të përshtatshme për përmbartim sepse debitorit i është dorëzuar vetëm kontrata me titull “furnizim dhe ventilator aksial” e datës 03.10.2023, ndërsa dokumentet të tjera nuk janë të bashkangjitura në propozim dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet sipas nenit 38 dhe nenit 40 të LPP-së. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin përmbartimor.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor nuk është e përshtatshme për përmbartim nuk qëndrojnë, për faktin se fatura është paraqitur në origjinal dhe e njëjta është pranuar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se përmbartuesi privat ka lejuar urdhrin përmbartimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 05/2023, e datës 03.10.2023, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga

ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga vula e protokollit për pranimin e shkresave të debitorit dhe nënshkrimi. Për më tepër, bazuar në shkresa të lëndës, fatura objekt përmbarimor buron nga kontrata për furnizim e lidhur me datë 14.09.2023, mes palëve, përkatësisht kreditorit në cilësi të furnizuesit dhe debitorit në cilësi të autoritetit kontraktues ndërgjyqëse me datë dhe nënshkruar nga debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1922/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.